

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për qendrat e votimit për bashkitë, ku do të zhvillohet votimi dhe numërimi elektronik. Po, zoti Sekretar.

Z. Y. Merkaç: Faleminderit! Referuar vendimit nr. 16, datë 13.4.2023 të Komisionit Rregullator në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 procesi i votimit do të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë. Në zgjedhjet për Kuvendin në vitin 2021 votimi dhe numërimi elektronik u zhvillua në Njësinë Administrative nr. 10 Tiranë ose KZAZ-ja nr. 40 me 32 qendra votimi dhe 23.597 zgjedhës, dhe në zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022 në Bashkinë Vorë me 44 qendra votimi me 30.053 zgjedhës. Në të dy këto raste për siguri u prodhuan edhe fletë votimi për çdo qendër votimi, por në asnjërin rast nuk lindi nevoja të përdreshin këto fletë votimi. Në tre bashkitë Elbasan, Kamëz e Vorë në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 janë përkatësisht 222 qendra votimi për Elbasanin; 113 për Kamzën dhe 44 qendra votimi për Bashkinë Vorë. Pra gjithsej janë 401 qendra votimi me 311.846 zgjedhës. Nisur edhe nga përvoja e Njësisë Administrative, KZAZ-së nr. 40 me 30 mijë zgjedhës dhe Bashkinë Vorë mendohet që të mos printohen të gjitha fletët e votimit për të gjitha qendrat e votimit, por të jetë një sasi më e vogël, në masën 10% . Për përdorimin e kësaj sasive, duke qenë se nuk dihet se në cilat qendra votimi do të mund të lind e nevojshme edhe përdorimi i këtyre fletëve të votimit, do të bëhet një numërim ose kodifikim i veçantë i KZAZ-ve dhe qendrave të votimit të nevojshme edhe si element sigurie. Qarku dhe bashkua janë plotësisht të përcaktuara dhe kanë kodin e tyre dyshifror. Kodet e ZAZ-së dhe QV-së do të jenë variabël duke ruajtur edhe sasinë e karaktereve të tyre. ZAZ-ja dy

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

karaktere dhe qendra e votimit 7 karaktere me gjithë vijën e pjerrët ose sleshin. Në këto 3 bashki janë 7 ZAZ dhe 401 QV. Për ZAZ-të mendohet të përdoren kode nga E1 deri E7, për QV-të mendohet të përdoren kodet PENV/01 deri PENV/40 ose që përkon me 10% të QV-ve, të ndara këto sipas sasisë që ka në çdo ZAZ. Meqë janë 400 qendra votimi për 10% ose 40 qendra votimi mendohet që QV-të të përdorin 1000 fletë votimi, gjithsej 40 mijë fletë votimi. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Ne u kemi kërkuar të gjitha partive politike të jepnin një mendim e një opinion në lidhje me këtë çështje e do të vendosim me konsensus të plotë të partive politike në lidhje me këtë çështje. Disa kanë kërkuar që të printohet e gjithë sasia e fletëve të votimit edhe për këto bashki. Nuk e di përfaqësuesit e partive të tjera politike? Ne kemi pasur idenë që të prodhohej në një sasi të kufizuar dhe të kishte një protokoll për administrimin e këtyre fletëve, por duket që nuk ka konsensus për këtë. Gjithsesi, disa përfaqësues të partive janë këtu.

Z. Sh. Sulo: Faleminderit, zoti Kryetar! Ne do ta paraqesim me shkrim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve qëndrimin tonë në lidhje me këtë çështje!

Z. I. Celibashi: Dakord.

Z. A. Kaziaj: Zoti Kryetar, është shumë e rëndësishme, në fund të fundit, pavarësisht se qëndrimi që sapo thatë ju nga KQZ-ja ka të bëjë me prodhimin e një sasive të caktuar të fletëve, të paktën për tre nga bashkitë ku këto zgjedhje do të bëhet projekti pilot, të votimit elektronik, pra në bashkitë Elbasan, Kamëz e Vorë. Fakti është që duhet të prevalojë në çdo rast, pavarësisht ngarkesës së karakterit financiar,

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

administrativ të KQZ-së për t'u garantuar qytetarëve votime demokratike, të qeta e të gjithanshme dhe të barabarta, futja e teknologjisë në zgjedhje është e mirëpritur nga të gjitha subjektet politike për shkak se redukton kostot në vetvete dhe jep edhe më shumë garanci të atij që mund të jetë qëllimshmëria e faktorit human, njerëzor, ose gabimi njerëzor që mund të quhet, pavarësisht kësaj, mendojmë që është një e drejtë kushtetuese që u duhet garantuar votuesve shqiptarë dhe si e tillë duhet të prevalojë në çdo rast. Jemi të qëndrimit duhet të printohen dhe të porositen fletët e votimit sikur në rastin më ekstrem në ndodhinë e ndonjë force madhore ose ndonjë gjë që shkon përtej asaj që është teknologjia në zgjedhje, probleme të karakterit teknik, të pazgjidhshme aty për aty, ju rikujtoj që cenohet një e drejtë kushtetuese në këtë rast dhe si e tillë duhet të garantohet nga ana juaj si përfaqësues i këtij institucioni. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, edhe ju jeni i mendimit që të prodhohet e gjithë sasia e fletëve të votimit për të shmangur ndonjë eventualitet të lidhur me ndonjë problematikë teknike të votimit elektronik, edhe pse jemi të gjithë besimplotë që nuk do të ketë të tilla, por gjithsesi, për të pasur të gjitha garancitë, sikurse e thashë edhe në krye të herës që kjo është një vendimmarrje që kërkonte konsensus të plotë nga palët pjesëmarrëse në garë, kështu që do t'i ngelemi vendimmarrjes për prodhimin e sasisë së plotë të fletëve të votimit edhe për këto tri bashki, sikurse edhe për bashkitë e tjera. Pra, numri i zgjedhësve plus 2%. Kështu që do të bëjmë një ndryshim tek vendimi që kemi marrë në lidhje me prodhimin e sasisë së fletëve të votimit për këto zgjedhje. Këtë projektvendim nuk e kalojmë. Besoj jeni dakord. Dakord? Faleminderit!

Vendimi nr. 394

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

Data 20.04.2023

Ora 12:19

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 1977/00, QV nr. 1977/01, QV nr. 1977/02, QV nr. 1977/03, QV nr. 2021/00, QV nr. 2021/01, Bashkia Tiranë, QV nr. 1080/00, Bashkia Bulqizë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Z. E. Meta**

- **Parti Politike:** **PL (A. Kaziaj), BF, PDIU (Sh. Sulo, K. Xhemali)**

- **OJQ:** **OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës që lidhet me dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit të ambienteve.

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 62, pika 4, të Kodit Zgjedhor, vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para ditës së zgjedhjeve, përveç rastit ku për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Referuar kësaj dispozite, në Komisionin Qendror të

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

Zgjedhjeve është administruar shkresa e administratorit të njësisë administrative nr. 9, autorizuar nga kryetari i bashkisë Tiranë, për dhënie autorizimi për ndryshimin e 4 qendrave të votimit, konkretisht QV nr. 1977/00, QV nr. 1977/01, QV nr. 1977/02 dhe QV-së nr. 1977/03, nga ambientet e Policisë Bashkiake (ish-ALUIZNI) në shkollën “7 Marsi”, si institucioni më i afërt për vendosjen e kësaj qendre votimi. Gjithashtu, Administratori i njësisë administrative nr. 11, autorizuar nga kryetari i bashkisë Tiranë, ka kërkuar dhënie autorizim për ndryshimin e 2 qendrave të votimit në ambiente private të zotit Xhevahir Hysa, qendra e votimit nr. 2021/00 dhe qendra e votimit nr. 2021/01. Lokali është i ndarë në dy ambiente të ndrysmë, të cilat do të shërbejnë si qendra votimi dhe këto ambiente kanë shërbyer si qendra votimi edhe në zgjedhjet e kaluara. Gjithashtu, edhe kryetari i Bashkisë Bulqizë ka kërkuar dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së një qendre votimi, konkretisht të QV-së nr. 1080/00 me adresë: Trebisht-Çelebi, shkolla, cila do të kalojë në shkollën 9-vjecare “10 Dëshmorët” Trebisht, fshati Muçinë. Nga administrata e KQZ-së është bërë verifikimi i këtyre qendrave të votimit dhe rezulton që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor për të qenë e për të shërbyer si qendra votimi. Për këtë arsye i propozojmë Komisionerit dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së këtyre qendrave të votimit. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike. Përfaqësuesi i koalicionit "Bashkë Fitojmë".

Z. A. Kaziaj: Faleminderit, zoti Kryetar! Unë habitem sesi Sekretari i Përgjithshëm me kaq lehtësi ju cilëson faktin që ne autorizojmë ndryshime të qendrës së votimit, ndërkohë që ligjvënësi, ligj të cilin Sekretari i Përgjithshëm duhet ta zbatojë, në nenin 62, që ai vetë saktësoi, në pikën 4 të tij, në fjalinë e dytë thotë: “Vendndodhja

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja”. A mund të na thotë Sekretari i Përgjithshëm se cila ka qenë forca madhore që ka autorizuar kryetari i Bashkisë Tiranë këtë rast dhe kryetari i Bashkisë Bulqizë për ndryshimin e këtyre qendrave të votimit, ndërkohë që ligji elektoral nuk e garanton këtë të drejtë në 40 ditë përpara zgjedhjeve. Sa ditë përpara zgjedhjeve jemi?

Z. I. Celibashi: Kemi ndonjë informacion të detajuar në lidhje me këtë kërkesë në si KQZ?

Z. Y. Merkaj: Projektvendimi u është dërguar partive politike për mendim. Nuk ka kthyer asnjë përgjigje. Unë mund t’i përgjigjem edhe kërkesës së përfaqësuesit të partisë...

Z. I. Celibashi: Edhe këtu kanë të drejtë. Lerë çfarë kanë sjellë me shkrim.

Z. Y. Merkaj: Administratori i njësisë administrative nr. 9, Tiranë, i ka vendosur qendrat e votimit në ambientet e Policisë Bashkiake. Kjo është e papranueshme dhe administrata e KQZ-së e ka orientuar që të hiqen nga ambientet e Policisë Bashkiake dhe të vendosen në një ambient tjetër në shkollë.

Z. I. Celibashi: Kur i ka caktuar në fillim, i ka caktuar në ambientet e Policisë Bashkiake.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

Z. Y. Merkaç: Tani është pakujdesi ose gabim, por është e papranueshme për administratën e KQZ-së.

Z. I. Celibashi: Kush e ka konstatuar që këto qendrat e votimit janë vendosur në ambientet e Policisë Bashkiake?

Z. Y. Merkaç: KZAZ-ja që ka shkuar dhe administrata e KQZ-së, inspektori.

Z. I. Celibashi: Nga verifikimet që kemi bërë ne, ka rezultuar. Ne ia kemi vënë në dijeni që këto qendra votimi që ke caktuar... Çfarë shpjegimi ka dhënë për këtë? Se me dashje nuk besoj se është...

Z. Y. Merkaç: Besoj se pakujdesi është.

Z. I. Celibashi: Apo ka dhënë ndonjë arsye tjetër? Këtë duhet të kërkonte përfaqësuesi.

Z. A. Kaziq: Faleminderit për shpjegimin, një shpjegim alogjik, që një përfaqësues që paguhet nga taksat e qytetarëve nuk dikërka se ku duhet vënë një qendër votimi dhe vëka përpara një institucioni publik, siç është Policia Bashkiake. Si ka mundësi 4 apo 6 QV-të që kërkohet ndryshimi qenkan vënë në Policinë Bashkiake? Unë do të doja që ju, zoti Komisioner, për tagrat që ju njeh ligji të parashikoni ato që është vullneti i ligjvënësit, sepse kjo po bëhet një lojë shumë e pisët. Në nenin 168 e vijues të Kodit Zgjedhor të merrni masa kundrejt personave të papërgjegjshëm, që qëllimisht fillimisht caktojnë një zonë të caktuar për vendndodhjen e qendrës së votimit dhe më vonë me qëllimshmëri të theksuar kjo gjë, i ftoj të gjithë gazetarët që

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

janë prezentë, shoh që janë edhe përfaqësues të OSBE/ODIHR-it, dhe të gjitha organizatat jofitimprurëse, KRIIK-un e të gjithë, që të hetojnë lidhur me këtë fakt, sepse po kërkohet në çdo mbledhje pranë këtij komisioni, pranë jush si Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ndryshimi i vendndodhjeve të qendrave të votimit me qëllimshmëri për shkak të papërgjegjshmërisë së personave publikë që e kanë për të detyrë për të dhënë një garanci te votuesit se ku do të votojnë dhe në këtë rast po sjellin një dëm të theksuar se vetë votuesi i asaj qendre votimi nuk po dinë se ku do të votojë dhe kjo është skandaloze. Do t'ju ftoja të merrni masa ndaj këtyre personave, qoftë edhe kryetari i bashkisë që jep autorizimin dhe personi përgjegjës që është kryetari i njësisë administrative. Është e papranueshme kjo gjë të ndodhë më, ndërkohë që ligji e thotë “për forcë madhore”. Në qoftë se forca madhore është papërgjegjshmëria e një zyrtari publik, të paktën në interpretimin tim si jurist në forcë madhore nuk hyn papërgjegjshmëria e një personi, hyn qëllimshmëria e një personi.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Unë jam plotësisht dakord me çfarë pretendon përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Do të bëjmë një vlerësim për atë situatë, sepse, në fund të fundit, nëse nuk do të ishte verifikuar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KZAZ-së, qendrat e votimit do të ishin në ambientet e Policisë Bashkiake. Të vlerësohet dhe, nëse është rasti për të vendosur sanksione, do të vendosim edhe sanksione. Dakord. Do të duhet të kenë një raport, një informacion edhe përfaqësuesit e partive politike në lidhje me këtë moment.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

**Data 20.04.2023
Ora 12:27**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Z. E. Meta**

- **Parti Politike:** **PL (A. Kaziaj), BF, PDIU (Sh. Sulo, K. Xhemali)**

- **OJQ:** **OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me për caktimin e partive që do të kenë të drejtën për të pasur anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit. Po, zoti Sekretar.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të nenit 96, pika 2 e Kodit Zgjedhor organizon seancë publike hedhjen e shortit ndërmjet partive politike për përcaktimin e partisë politike që propozon anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit. Neni 95, pika 2 e Kodit Zgjedhor parashikon se

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

anëtari i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse, ndërsa anëtari i katërt emërohet pas propozimeve të partive të opozitës, që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e katërt të GNV-ve për KZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të Kodit Zgjedhor. Neni 96, pika 1 parashikon se partitë politike kanë të drejtë dhe propozojnë anëtarin e katërt, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe në nënkryetarin e KZAZ-së. Me vendimin numër 555, datë 26.07.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur rezultatin parlamentar të zgjedhjeve të datës 25 qershor të vitit 2017 për Kuvendin e Shqipërisë dhe numri i mandateve të fituara nga partitë politike, është si më poshtë: Partia Socialiste: 74 mandate, Partia Demokratike: 43 mandate, Lëvizja Socialiste për Integrim: 19 mandate dhe Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet: 3 mandate, Partia Socialdemokrate: 1 mandat. Për partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin është Partia Socialiste dhe Partia Demokratike, që nuk renditen në listën e partive që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katër. Ndërsa partitë politike, që kanë fituar në zgjedhjet e vitit 2017 jo më pak se 2 mandate përveç partive që propozojnë kryetar dhe nënkryetar, janë Lëvizja Socialiste për Integrim, sot Partia e Lirisë dhe Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet. Për këto arsye, referuar dhe nenit 2, pikat 2 dhe 3 të udhëzimit nr. 5, datë 16.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, e cila përcakton procedurën e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e katërt të grupeve të numërimit kemi që nga partitë politike të shumicës parlamentare, Partia Socialdemokrate nuk përmbush kriterin e numrit të mandateve për të qenë pjesë e shortit në caktimin e anëtarit të tretë të grupit të numërimit. Në këto kushte Partia Socialiste është e vetmja parti që plotëson kriterin e numrit të mandateve nga partitë e shumicës parlamentare për të propozuar anëtarin e tretë të grupit të numërimit, por partitë politike të opozitës parlamentare: Partia e Lirisë, ose Partia Lëvizja

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

Socialiste për integrim dhe Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, përmbushin kriterin e numrit të mandateve dhe iu lind e drejta për të propozuar anëtarin e katërt të grupeve të numërimit. Anëtari i katërt, do të përcaktohet në bazë të rezultatit të për çdo ZAZ nëpërmjet Partisë së Lirisë dhe Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet.

Z. I. Celibashi: Po, Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës?

Z. A. Kaziaj: Po faleminderit, zoti Kryetar! Ne totalisht nuk jemi dakord me këtë propozim të bërë nga administrata, konkretisht nga sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, lidhur me interpretimin që i bën ligjit, ndërkohë kemi shumë të qarta dispozitat ligjore, të cilat e përcaktojnë qartë se kush e merr anëtarin e katërt të GNV-së, ashtu siç kemi të qarta qëndrimet e mbajtura nga Kolegji Zgjedhor që është institucioni gjyqësor suprem kundrejt të cilit nuk mund të bëhet as ankim, të themi në qëndrimet e tij, lidhur me vendimmarrjet e këtij të fundit në vite, me radhë, qoftë edhe pas atyre që kanë qenë ndryshimet e vitit 2020 me ligjin 101 dhe 118. Po ashtu edhe praktika e këtij institucioni tashmë është e qartë. Veç kësaj kemi ardhur në dijeni të një shkrese, të bërë nga ana juaj, zoti Komisioner, që mban numrin e protokollit 3957, datë 19.04.2023, drejtuar Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, me lëndë: Kërkohet informacion mbi shumicat dhe pakicat me përfaqësim politik në Kuvend. Ndërkohë që ju keni bërë dy pyetje, besoj se këto pyetjet tuaja janë marrë në atë që është dispozita kalimtare neni 183 të Kodit Zgjedhor, ndërkohë që ju sjell në vëmendje jo vetë këtë dispozitë, por frymën që ligjvënësi ka përcaktuar këtë dispozitë në ndryshime e bëra në vitin 2020 që ka të bëjë dhe me qëndrimet e mbajtura të një partie të caktuar politike ose përfaqësuesve të vet në Kuvend. Kam një dokument zyrtar, të cilin do t'jua vë në

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

dispozicion juve, si Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve, lidhur me qëndrimet e mbajtura nga përfaqësues të PDIU-së, që janë: Shpëtim Idrizi, Mesila Doda dhe Nusret Avdula, të cilët kanë votuar qartësisht pro partisë në pushtet për çdo vendimmarrje të marrë nga ajo. Dhe si të tillë do të doja ta merrni parasysh, ta shtynit këtë seancë, pasi të biem në një qëndrim politik dhe teknik të mbajtur dhe ligjor, se ju zbatoni ligjin dhe ne kërkojmë vetëm zbatimin e ligjit nga ana juaj, dhe më pas ta sillni për miratim pranë këtij institucioni. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Me sa kuptova kërkuat që dy pyetjeve, që ne i kemi drejtuar Kuvendit, t'i shtojmë dhe një të tretë.

Z. A. Kaziaj: Ekzaktësisht t'i shtohet dhe një pyetje e tretë ku të kërkohet se cili ka qenë qëndrimi i 3 deputetëve të PDIU-së në Kuvendin e Shqipërisë, lidhur me vendimmarrjet për projektligjet e miratuara në Kuvend, në këtë legjislaturë.

Z. I. Celibashi: Në këtë legjislaturë për vitet nga 2021 - shi e këtej.

Z. A. Kaziaj: Në mënyrë që të shihet qartë se kujt i përkasin, i përkasin opozitës, apo i përkasin mazhorancës. Kjo edhe në kuadër të balancimit që vetë ligjvënësi i ka vënë Kodit Zgjedhor dhe vetë fryma e qëndrimet e mbajtura nga ndërkombëtarët dhe nga OSBE-ODIHR-i, lidhur me balancimin, baraspeshimin politik jo vetëm në grupet e numrit të votave, por në çdo aspekt që ka të bëjë me zgjedhjet, për shkak se lihet zbuluar totalisht opozita nëse nuk zbatohet ligji. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

Z. Sh. Sula: Faleminderit, zoti Kryetar, në mënyrë të habitshme, sa herë ne kemi zgjedhje, përfaqësuesi i partisë LSI, ngre...

Z. A. Kaziqaj: Jam përfaqësuesi i “Bashkë Fitojmë” dhe i Partisë së Lirisë.

Z. Sh. Sula: Zoti kryetar, do të kisha dëshirën të flisja dhe të mos më ndërhynte njeri, sepse zotërinë ne nuk e shqetësuam fare, megjithëse ai në çdo moment ka dëshirë të flasë. Pra, ndodhi çudia që në sesionin e kaluar ishte argumenti: kemi qenë parti koalicioni, ndërsa këtë radhë, mesa kuptova edhe unë meqë KQZ-së i është kërkuar dhe informacion drejtuar Kuvendit të Shqipërisë janë qëndrimet e mbajtura nga deputetë të caktuar të kësaj partie politike, kur dihet botërisht që PDIU-ja është parti opozitare. Unë ndoshta e kuptoj shumë mirë kolegun nga emocionet që i krijohen, sepse tashmë është bërë ...

Z. I. Celibashi: Ju lutem, këto vërshime kundrejt njëri- tjetrit...

Z. Sh. Sula: Ju lutem, është bërë dhe përfaqësues i Partisë Demokratike, i partisë së studentëve të dhjetorit, ku unë kam qenë pjesë edhe vetë. Më vjen shumë mirë që një përfaqësues, i cili mbante shallin apo mban shallin e pionierit dhe çdo datë 5 maj shkon pranë varrezave të dëshmoreve apo më datën 8 dhjetor feston me kërshëri lindjen e partisë së tij, çuditërisht vjen dhe intimidon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke bërë kërkesa të tilla. Unë kam besim, zoti Kryetar, sepse, duke iu referuar nenit 19, shkronja “dh”, të ligjit, të Kodit Zgjedhor “Kompetencat e Komisionerit” thuhet: Kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë të përpiktë të saktë dhe uniformë nga institucionet subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime sipas ligjit. Kemi përpara një Komisioner, i cili në dijeninë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

time kaq vite kryetar sa shteti i Kosovës ka fituar pavarësinë, dhe s'i kam vë në asnjë herë në dyshim aftësinë dhe korrektësinë në zbatimin e ligjit, por, le t'i referohemi projektvendimit të sjellë nga administrata e KQZ-së dhe jo nga sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në faqen e parë të saj, pasi lexohet titulli "Caktim partie politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV –ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj" thuhet se Komisioneri bazohet në përcaktimet e këtij Kodi Zgjedhor. Dhe konkretisht në nenin 95, pika 2 parashikohet se anëtari i tretë propozohet nga partitë politike të shumicës qeverisjes, dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës. A jemi parti opozitare ne PDIU-ja apo jo? Patjetër që po. Vazhdojmë më tutje në nenin 96, paragrafi i parë, parashikohen partitë politike, ku të paktën një nga partitë e opozitës të ketë fituar jo më pak se dy mandate, pra neve jemi me 4 mandate aktualisht në Kuvendin e Shqipërisë, referuar dhe vendimit numër 555, datë 26.07.2017, të cituar nga administrata e KQZ-së. Nëse do t'i referohemi një vendimi, pra një praktike të njësuar apo edhe shembujve të tjerë të marrë për këtë gjë, kemi një vendim të Kolegjit Zgjedhor, i cili është i vitit 2017. Pothuajse jemi të gjithë juristë dhe e kuptojmë, pra që është e saktësuar shumë qartë se kujt i takon anëtari i katërt i grupeve të numërimit, pra, midis kujt duhet të hidhet shorti. Prandaj, zoti gjyqtar, do të më pëlqente ta thosha përsëri, sepse normalisht duhet ta saktësoni shumë mirë dhe të jepni një zgjidhje sa më të saktë këtij vendimi në lidhje me aftësitë tuaja, kërkoj miratimin e këtij projektakti dhe caktimin e anëtarit të grupeve të numërimit, i cili do të bëhet sipas ligjit të Kodit Zgjedhor. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Partisë së Lirisë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

Z. A. Kaziqaj: Nuk ju marr shumë kohë, zoti Celibashi, e di që është e vyer koha në këto momente për të gjithë ne dhe, në mënyrë të veçantë, për ju që keni detyra zgjedhore dhe afate të tilla të parashikuara nga ligjvënësi. Shumë qartë ju thashë edhe në fillim të fjalës sime, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, që ka të bëjë në vetvete me një qëndrim të mbajtur dhe të njësuar tashmë të vendimmarrjes së Kolegjit për vite me radhë, një qëndrim të mbajtur nga vetë fryma e ligjvënësit në balancim të pushtetit, siç e thashë, midis pozitës dhe opozitës, dakordësitë politike në fund të fundit, mbi të cilën janë bërë dhe ndryshimet e vetë Kodit, po ashtu konfirmimi i mëtejshëm është ajo që unë thashë si votimi i qëndrimeve të mbajtura nëpërmjet votës së anëtarëve ose të deputetëve të PDIU-së dhe për më tepër, dhe ju vetë, nëpërmjet shkresës suaj, për të qenë ju sa më në rregull për atë që do të jetë vendimmarrja juaj në fund të fundit në zbatim të parashikimeve të Kodit Zgjedhor, i jeni drejtuar Kuvendit të Shqipërisë saktësisht Kryetares së Kuvendit, zonjës Nikolla, me këto pyetje. Unë do të doja të shtronim dhe pyetjen e tretë, nëse ju do ta konsideroni të arsyeshme dhe në interes të balancimit, që duhet të jetë në zgjedhje, t'ia shtroni pyetjen e tretë Kryetares, të keni një përgjigje dhe të konsolidoni vendimmarrjen tuaj në frymë dhe në gërmë të ligjit. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i PDIU-së.

Z. Sh. Sula: Faleminderit! Ne do të kërkojmë që kjo kërkesë të mos merret parasysh nga ana juaj, sepse nuk është parlamenti, i cili përcakton këtë kërkesë, që kërkon pala nga ana e përfaqësuesit. Prandaj shkresa është e qartë, është konform ligjit akti i sjellë, prandaj të mos zgjatemi, zoti Kryetar, kërkojmë miratimin e saj.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i PL-së.

Z. A. Kaziaj: Gjithsesi, le ta marrë fjalën nëse ju ia jepni, por fakti është që ky është qëndrimi i përfaqësuesit të PDIU-së, që është një qëndrim opozitar sipas tij, që të mos i bëni kërkesë parlamentit se çfarë ka votuar PDIU-ja, dhe na hiqen si opozitar në këtë rast.

Z. I. Celibashi: Keni të drejtën e fjalës.

Z. Sh. Sula: Faleminderit! Unë nuk kam pse ta përsëris që emocionet e kolegut tim për të mbrojtur partinë e dhjetorit janë absurde, prandaj nuk e kuptoj se çfarë kërkon.

Z. A. Kaziaj: Emocionet tuaja për të shitur kauzën e partisë së dhjetorit janë absurde.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, të dy përfaqësuesve për kontributet e tyre. Në vijim edhe të qasjes sime ndaj kërkesave të ndryshme të përfaqësuesve të partive politike edhe për të mos lënë jo vetëm shkak po asnjë lloj preteksti për të paktën për këtë arsye të kontestimeve të vendimmarrjeve të Komisionerit, do ta përmbushim kërkesën e përfaqësuesit të Partisë së Lirisë, dhe do të kërkojmë të marrim informacionin e kërkuar pa vlerësuar dhe pa mbajtur një qëndrim në lidhje me dobishmërinë në këto momente të kërkesës apo edhe të përmbajtjes së përgjigjes në reflektim të kërkesës. Duke pasur të gjitha çfarë ju keni kërkuar për t'i pasur në vlerësim të kësaj çështjeje mendoj që të paktën do të mungojë preteksti që nuk është vlerësuar ky apo ai dokument apo kjo apo ajo e dhënë. Kështu që do ta

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.04.2023*

përmbushim kërkesën tuaj duke i kërkuar Kuvendit të Shqipërisë sa ju kërkuat. Faleminderit! Do të synojmë ta marrim përgjigjen sa më shpejt që ndoshta ditën e shtunë të zhvillojmë seancën për këtë çështje, pra të vazhdojmë shqyrtimin e kësaj çështjeje. Faleminderit! A kemi çështje të tjera? Nuk kemi. Dakord. Ditë të mbarë! Gëzuar ditën e Bajramit, që është nesër!

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

